



Pranuar / Dorezuar / Primjen / Prodato / Received / Delivered		27 - 09 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojça Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOMBATEK	5702/2022		119	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.682/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.682/2022 të datës 02.08.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 27.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.682/2022 e datës 02.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 01.08.2022 me numër protokolli 928/2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Shërbim të Votuesve", me datën 02.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4470/2022 kundër Vendimit të datës 01.08.2022 me numër protokolli 928/2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon që t'i njihet e drejta e kompensimit në mënyrë retroaktive për diferencën në pagë për pozitën e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së, nga data 07.06.2019 deri me datë 31.08.2020 si dhe kompensimin për

shtesa për punë jashtë orarit për pozitën e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së lidhur me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës në vitin 2019 sipas Vendimit Nr.826-2019 i datës 27.08.2019 si dhe kompensimin për shtesa për punë jashtë orarit lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës në vitin 2020 sipas Vendimit Nr.826-2019 i datës 08.02.2020 për zgjatjen e orarit të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 05.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa kjo e fundit me datë 22.08.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4846/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4470/2022 të datës 02.08.2022 me numër A.nr.682/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kopja e konkursit e shpallur me datë 20.04.2019; Njoftim për vazhdimin e afatit të konkursit; Vendimi i datës 07.06.2019 me nr.630/2019; Arsyetim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 02.08.2019; Njoftimi i datës 11.10.2019 me numër protokollit 4770/2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 14.08.2020; Akt emërimi i datës 01.09.2020; Kopja e konkursit e datës 25.06.2020 për pozitën Kryeshef Ekzekutiv në SKQZ; Prova 9 njoftim për kandidatin e suksesshëm me numër ref.KQZ-15/2020; Vendimi i datës 24.09.2020 me nr.809/2020; Kopja e konkursit e datës 21.02.2022 për pozitën e Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv në SKQZ; Njoftim për kandidatin e suksesshëm e datës 10.03.2022; Njoftimi i datës 10.03.2022 për Drejtor Ekzekutiv në ZRPPC; E-mail zyrtar i datës 28.03.2022; Provë 13/19 Kërkesa përmes e-mailit e dërguar me datë 31.03.2022; Kërkesa e datës 31.03.2022; Ankesa e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e datës 01.07.2022; Vendimi i datës 01.08.2022 me numër protokollit 928/2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i SKQZ-ës; Llogaritja e diferencës së pagës; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 22.08.2022 me numër protokollit 4846/2022 bashkë me provat e lëndës ; Vendimi i datës 07.06.2019 me nr.630/2019; E-mail zyrtar i datës 28.03.2022; Prova 9/2 -Kërkesë e datës 31.03.2022 për kompensimin dhe realizimin e diferencës së pagës; Kopja e konkursit e datës 01.01.2022; Vendimi A.nr.497/2021 i datës 23.06.2021 me numër protokollit 3274/2021 i KPMSHCK-së; Korrigjimi i vendimit me datë 30.06.2021 i KPMSHCK-së; Vendimi i datës 12.07.2021 për zbatimin e vendimit të KPMSHCK; Aktvendimi i datës 07.07.2021 A.nr.1479/2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendim i datës 12.07.2021 me nr.1800/2021; Vendim i datës 15.07.2021 me nr.1825/2021; Vendim i datës 28.10.2021 me nr.2857/2021; kërkesë për rishqyrtimin e vendimit nr.2857 të datës 25.10.2021 dhe Vendimi i datës 20.12.2021 me nr.3542/2021 për shfuqizimin e vendimit të KQZ-së nr.2857/2021 të datës 25.10.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga administrimi provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi mban pozitën e punës *“Udhëheqës i Divizionit për*

Shërbimin Votues". Ankuesi në procedurën e rekrutimit për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv të SKQZ-së të shpallur përmes konkursit të datës 20.04.2019 ishte shpallur kandidat i suksesshëm, mirëpo i njëjti nuk ishte emëruar në pozitë pasi që për procedurën në fjalë njëri nga kandidatit pjesëmarrës në këtë konkurs kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarura Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa për lëndën në fjalë e identifikuar me shifrën A.nr.480/2019 të datës 20.08.2019 Këshilli nuk kishte mundur të vendos duke e udhëzuar palën të vazhdojë tutje procedurën ankimore në instanca gjyqësore, mirëpo Komisioni Qendror Zgjedhor pavarësisht që procedura e rekrutimit ishte ende në procese ankimore i kishte lëshuar ankuesit akt emërimit të datës 01.09.2020 me numër:763-2020 duke e konfirmuar në pozitën e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së.

Po ashtu, Këshilli sipas obligimit ligjor me qëllim të zbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative, kishte vendosur përmes Vendimit A.nr.497/2021 të datës 23.06.2021 duke e anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën "*Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së*" për të cilën pozitë ankuesi ishte shpallur kandidatë i suksesshëm për emërim, ndërsa me qëllim të zbatimit të Vendimit të Këshillit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 12.07.2021 ka nxjerrë Vendimin më numër:1795-2021 përmes të cilit ishte shfuqizuar vendimi për emërimin e ankuesit në pozitën "*Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së*".

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji i këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 130 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "*Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën*", dhe ka konstatuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me rastin e mos emërimit gjegjësisht mos lëshimit të aktit të emërimit ankuesit deri me datë 31.08.2020 ka vepruara në pajtueshmëri me dispozitën e lartcekur, ndërsa lëshimi i aktit të emërimit me datë 01.09.2020 dhe numër:763-2020 ka qenë në kundërshtim me frymën e kësaj norme ngase procedura e filluar ankimore sipas ankesës A.nr.480/2019 të datës 20.08.2019 ende nuk ishte zgjedhur me vendim përfundimtar në procedurë administrative, andaj në kuptim të nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: "*Paga bazë, sipas këtij ligji është rezultat i çmimit të punës, përkatësisht vlerës për punën e thjeshtë dhe koeficientet e caktuar për çdo grup e nëngrup, si dhe shumat e rritura të përvojës së punës, për çdo vit të plotë, në përqindje të caktuar*", Kolegji i Këshillit thekson faktin se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara ngase me asnjë fakt apo prove relevante ankuesi nuk mundet ta dëshmojë se zyrtarisht ndërmjet periudhës kohore nga data 07.06.2019 deri me datë 31.08.2020 ta ketë ushtruar pozitën e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së, si rrjedhojë përderisa faktikisht dhe as juridikisht nuk e ka ushtruar këtë pozitë nuk mundet të kompensohet në mënyrë retroaktive sipas pretendimeve ankimore, qoftë për diferencën në pagë apo shtesa për punë jashtë orarit për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës në vitin 2019 apo për mbajtjen e zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës në vitin 2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe analizimit të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të KQZ-së me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.928-2022 të datës 01.08.2022, ka vepruar në pajtueshmëri me

dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, si dhe Udhëzimin e Administrativ të KQZ-së Nr.02/2018 për Procedurën e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave të SKQZ-së.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.682/2022, datë 27/09/2022.

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

